

AMBASADORI  
GLOBAL I  
**PAQES**



KALIFI  
MIRZA MASROOR AHMAD  
UDHËHEQËSI I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA

**PËR MË SHUMË SE NJË DEKADË  
KA PARALAJMËRUAR PËR LUFTË BOTËRORE**

ZBULONI SI TA NDALIM LUFTËN E TRETË BOTËRORE

**#STOPWW3**

XHEMATI  
MUSLIMAN  
AHMEDIA

MBËSHTETENI MESAZHIN E TIJ  
**stopWW3.co.uk**



## NË QERSHOR 2020,

SHENJTËRIA E TIJ, HAZRET MIRZA MASROOR AHMAD,  
KALIFI I XHEMATIT MUSLIMAN AHMEDIA,  
U SHKROI KËTË UDHËHEQËSVE BOTËRORE, DUKE  
PARALAJMËRUAR PËR LUFTËN E TRETË BOTËRORE:

*“Nuk mund të supozohet se, sapo të kalojë  
pandemia COVID-19, gjithçka do të zgjidhet  
papritmas. Përkundrazi, në horizont shoh se  
po afrohen shqetësime dhe trazira të tjera, për  
shkak të barrës së paprecedentë financiare  
dhe ekonomike që ky virus ka vendosur mbi  
shtetet dhe popujt e botës. Si pasojë, konflikte  
dhe përçarje të mëtejshme, si brenda vendeve  
ashtu edhe ndërmjet kombeve, janë qartazi të  
mundshme. Prandaj kam frikë se në muajt dhe  
vitet që vijnë do të shfaqen çarje gjithnjë e më  
të thella në paqen dhe stabilitetin e botës...”*

*Përdorni të gjitha mjetet dhe ndikimin tuaj  
për t’i udhëzuar udhëheqësit dhe popujt e  
botës drejt nevojës urgjente dhe parësore  
për të njohur Krijuesin e tyre dhe për të  
përmbushur të drejtat e njëri-tjetrit, në  
mënyrë që njerëzimi të shpëtojë nga pasojat  
e dëmshme të kësaj pandemie dhe nga  
shkatërrimi e rrënimi që padyshim do të  
shkaktonte një Luftë e Tretë Botërore.”*

## Fushata #STOPWW3



Shenjtëria e Tij, Hazret Mirza Masroor Ahmad, Simpoziumi i Paqes, Mbretëria e Bashkuar, 2018

Në vitin 1905, Themeluesi i Xhematit Musliman Ahmedia paralajmëroi botën për një luftë të tmerrshme globale, e cila do të përmbyste Carin e Rusisë dhe do të sillte një rend të ri shoqëror. Fjalët e tij profetike u përmbushën në Luftën e Parë Botërore 1914–1918. Emri i tij ishte Hazret Mirza Ghulam Ahmad a.s., dhe ai ishte Mesihu i Premtuar, i pritur nga të gjitha fetë e botës.

Për më shumë se një dekadë, Kalifi i tij i pestë, Hazret Mirza Masroor Ahmad, ka paralajmëruar botën për drejtimin e saj katastrofik drejt Luftës së Tretë Botërore.

Ai ka dhënë paralajmërime në Capitol Hill dhe në Parlamentin e BE-së në vitin 2012, si edhe në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2013, dhe për

disa vite u ka shkruar letra të shumta udhëheqësve botërorë. Përmes këtyre, ai ka bërë thirrje që politikatat ndërkombëtare dhe të brendshme të orientohen drejt paqes, të ndërtuar mbi themelet e drejtësisë absolute.

**Siç ka thënë Kalifi:**

**‘Paqja nuk mund të vendoset pa drejtësi. Dhe drejtësia nuk mund të vendoset pa krijuar një marrëdhënie me Qenien Supreme. Marrëdhënia me Krijuesin e kësaj bote është parakusht për drejtësinë.’** Ne i bëjmë thirrje botës që t’u kushtojë vëmendje fjalëve të Kalifit: të njohë Krijuesin, duke përmbushur njëkohësisht të drejtat e krijesave të Tij. Kjo është e vetmja rrugë drejt paqes

**Sign up to our campaign for peace at [stopww3.co.uk](http://stopww3.co.uk)**

GJITHÇKA QË SHOH ËSHTË  
NJË BREZ FËMIJËSH QË  
PO SHTYHEN NË KRAHËT  
E ATYRE QË KËRKOJNË  
TË SHKATËRROJNË PAQEN E BOTËS.

Kalifi, Mirza Masroor Ahmad



**#STOPWW3**

Xhemati  
Musliman  
Ahmedia  
i Shqipërisë

Për më shumë

[www.ahmadiyya-islam.org/al](http://www.ahmadiyya-islam.org/al)





RETË E STUHISË QË PARALAJMËROJNË

**NJË LUFTË TË TRETË BOTËRORE,**

**PO RËNDOHEN DITË PAS DITE.**

Kalifi, Mirza Masroor Ahmad

**#STOPWW3**

Xhemati  
Musliman  
Ahmedia  
i Shqipërisë

Për më shumë

[www.ahmadiyya-islam.org/al](http://www.ahmadiyya-islam.org/al)



---

## Rruga drejt Paqes

---

“Paqja nuk mund të vendoset pa drejtësi. Dhe drejtësia nuk mund të vendoset pa krijuar një marrëdhënie me Qenien Supreme. Marrëdhënia me Krijuesin e kësaj bote është parakusht për drejtësinë.”

(Hazret Mirza Masroor Ahmad, Simpoziumi i Paqes, UK, 2011)

Vizito [www.stopww3.co.uk](http://www.stopww3.co.uk) për të mbështetur nismën Rruga drejt Paqes.

### 1. TË NJOHIM KRIJUESIN

Të pranojmë se besimi në llogaridhënien përpara Krijuesit tonë të përbashkët mund të jetë themeli i vetëm i vërtetë për vendosjen e drejtësisë absolute.

### 2. TË VENDOSIM DREJTËSINË ABSOLUTE

Të veprojmë me drejtësi në të gjitha fushat e jetës, duke hequr dorë nga interesat vetjake dhe duke punuar gjithmonë për atë që është e drejtë.

### 3. TË NXISIM BASHKIMIN GLOBAL

Të vendosim barazinë e të gjitha kombeve në strukturat ndërkombëtare, si Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe Banka Botërore.

### 4. TË KËRKOJMË ÇARMATIMIN BËRTHAMOR

Të punojmë për çarmatimin e

shpejtë të armëve bërthamore, përdorimi i të cilave do të sillte vuajtje të patregueshme për njerëzimin dhe për mbarë planetin.

### 5. TË ELIMINOJMË PËRFITIMIN NGA ARMËT

Të vendosim njerëzit mbi fitimin, duke rregulluar tregtinë globale të papërgjegjshme të armëve.

### 6. TË KRIJOJMË BARAZI EKONOMIKE DHE TË ÇRRËNJOSIM VARFËRINË

T'i jepet fund skllavërisë së borxhit në çdo nivel dhe të vendoset e drejta sovrane e çdo populli për të pasur pjesë në pasurinë e burimeve të vendit të tij.

### 7. TË PUNOHET PËR TË MIRËN E VENDIT

Të punohet me frymë sakrifice vetëmohuese dhe dashamirësie për vendin ku njeriu banon, qoftë vendas apo jo.


### 8. TË HEDHIM POSHTË EKSTREMIZMIN

Sipas Islamit, asnjë fe nuk e miraton dhunën dhe gjakderdhjen, sepse të gjitha fetë kanë ardhur nga Zoti, i Cili i dërgoi profetët e Tij për të vendosur paqen.

### 9. TË NGULITIM SHËRBIMIN NDAJ NJERËZIMIT

Të nxitet dashuria e ndërsjellë dhe shërbimi për mbarë njerëzimin, pa dallim klase, ngjyre apo besimi.

## Mesihu i Premtuar<sup>as</sup> dhe Kalifi i tij




Shenjtëria e Tij, Hazret Mirza Ghulam Ahmed, Mesihu i Premtuar a.s., lindi në një familje fisnike në Kadijan të Indisë, në vitin 1835

Si musliman, ai besonte me vendosmëri se të gjitha fetë ishin të vërteta në zanafillën e tyre, por se Islami përfaqëson kulmin e përsosmërisë fetare, të mbështetur nga Zoti përmes shenjave të gjalla.

Mbrojtja e tij e sinqertë ndaj besimit u bekua përfundimisht dhe ai u caktua nga Zoti si Imam Mehdiu dhe Mesihu i Premtuar, i pritur nga të gjitha fetë. Misioni i tij ishte ta afronte njerëzimin me Krijuesin e tyre dhe t'i kujtonte njerëzimit përbushjen e detyrimeve që ka ndaj njëri-tjetrit.

Në vitin 1889, nën udhëzimin hyjnor, ai themeloi Xhematin Musliman Ahmedia. Ky Xhemat përfaqëson ringjalljen e Islamit, duke përhapur mesazhin origjinal dhe paqësor të këtij besimi.



Reformimi për të cilin ngarkohet një profet nuk mund të arrihet brenda jetës së tij, por kërkon përpjekjen e pandërprerë të ndjekësve të tij.

Kalifati është sistemi i pasueshmërisë shpirtërore, përmes të cilit misioni i profetit vazhdohet dhe përbushet.

Xhemati Musliman Ahmedia është përbushja e gjallë e profecisë së Profetit të Shenjtë Muhammed s.a.v.s., se në Ditët e Mëvonshme Kalifati do të rivendosej.

Sot jetojmë në epokën e Kalifit të Pestë, Hazret Mirza Masroor Ahmad. I njohur në mbarë botën si ambasador i paqes, ai ka kaluar vite duke këshilluar udhëheqësit botërorë se, nëse drejtësia nuk zbatohet në nivel ndërkombëtar, bota po shkon drejt Luftës së Tretë Botërore.

---

Regjistrohuni në fushatën tonë në:

---

**STOPWW3.CO.UK**

**#STOPWW3**

---

Më shumë në shqip

---

**na vizitoni në portalin**

[www.ahmadiyya-islam.org/al](http://www.ahmadiyya-islam.org/al)



Xhemati Musliman Ahmedia i Shqipërisë  
[www.ahmadiyya-islam.org/al](http://www.ahmadiyya-islam.org/al)



@TheTrueIslamUK